



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 50

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHOYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË MINISTRIT
TË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR
2025

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 5 (pesë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 10.00, me tematikë, “Tryezë diskutimesh”, “*Takim me kryepleqtë e zonës së Gjinarit*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 11.00, me tematikë, “Tjetër”, “Infrastrukturë”, “*Takim me pronaret e bujtinave të zonës se Gjinarit*”,

Data: 31.1.2025 Nr: 50
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 12:30, me tematikë, “Tjetër”, “mjedis”, “*Mbjellje pemësh në fshatin Valsh*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 13:00, me tematikë, “Tjetër”, “Infrastrukturë”, *Vizitë në Kishën e Valshit*”,
- Në datën 23.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 27.1.2025, ora 14:00, me tematikë, “Inspektim”, “Infrastrukturë”, *Inspektim në punimet e rrugës së Shushicës*.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Që nga momenti që kemi marrë statusin e KQZ që aktivitetet janë të ndaluara, këto aktivitete JANË ANULLUAR nga agjenda e ministrit dhe nuk janë kryer. Pra, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor NUK KA KRYER asnjë aktivitet që KQZ i ka vënë statusin i ndaluar.”*

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se veprimtaritë e raportuara jashtë afatit nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, të cilat pasi kanë marrë statusin “E Ndaluar” në NRI nuk janë zhvilluar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative, për aq sa këto aktivitete nuk janë zhvilluar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI